



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS
THE UNION THE INDEPENDENT OF KOSOVO
UNIA NEZAVISNIH SIDIKATA KOSOVA
Nr. fiskal : 6 00 26 77 93
Adress: Rr. Nënë Tereza Nr.35 10000 Prishtinë
Tel / +381/ 222 - 859, Fax/ +381/ 224 - 649:
Email: bspk@bspk.org

Duke u bazuar në gjendjen aktuale dhe shqetësimet e grumbulluara lidhur me të drejtat që u takojnë punëtorisë kosovare, Këshilli Organizativ i Protestës që përfaqëson 14 federatat sindikale të BSPK-ës, për mjetet e informimit publik lëshon këtë :

KOMUNIKATË

Ftohet punëtorët, punëtorët e mbetur papunë, studentët, shoqëria civile dhe pensionistët, që me dt. 29.05.2013 në ora 11: 55, të marrin pjesë në protestën e përgjithshme të organizuar nga BSPK, e cila do të mbahet në sheshin “Nënë Tereza” në Prishtinë, me moton *“pesë minuta para dymbëdhjetëve”*.

BSPK do të prezantoj me sloganet:

1. Kërkojmë zbatimin e ligjeve në praktikë për të drejtat e punëtorëve,
2. Kërkojmë nënshkrimin e marrëveshjes kolektive,
3. Kërkojmë zbatimin e marrëveshjes për pagën minimale, prej 220 €.
4. Kërkojmë miratimin e ligjit për pensionistët,
5. Kërkojmë pranimin e stazhit të punës për vitet 1990 - 1999.
6. Kërkojmë krijimin e fondit social për punëtorët, që privatizimi i la papunë.
7. Kërkojmë funksionimin e Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme për 20 % nga privatizimi i ndërmarrjeve.

Kërkesave të lartë cekura mund t'i bashkëngjiten edhe sloganet tjera, varësisht prej specifikave që i kanë shoqatat sindikale nga regjionet e Kosovës, si dhe të gjitha subjektet që e përkrahin këtë protestë.

Nga qendrat e Kosovës për në Prishtinë, transporti i protestuesve do të bëhet me autobus, nën organizimin e Këshillit të protestës.

Këshilli organizativ
i protestës

Prishtinë, 28.05.2013

vv.

Fehmi Pajaziti